



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 6898/11 Prot.

Tiranë më, 18/03 /2014

UDHËZIM nr. 02 datë 18.03 .2014

**Mbi zbatimin praktik të Udhëzimit nr. 2/1 datë 12.03.2014 të Ministrit të Financave
në lidhje me rentën minerare**

Në zbatim të Udhëzimit nr. 2/1 datë 12.03.2014 të Ministrit të Financave "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 26 datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare" të ndryshuar", Drejtori i Përgjithshëm i Doganave udhëzon:

1. Në momentin e eksportit, nga ana e zyrës doganore kryhen llogaritjet e plota të rentës minerare. Shuma e llogaritur përfaqëson rentën që duhet paguar për mallin e eksportuar. Kjo shumë shënohet në të gjitha rastet në kuadrantin 47 të DAV në rubrikën RML (renta minerare e llogaritur).
2. Në qoftë se eksportuesi ka blerë minerale për të cilat është paguar rentë prane organeve tatimore, atëherë eksportuesi deklaron shumën e rentës që ka paguar pranë organeve tatimore për pjesën që i takon mallrave që po eksportohen, duke i bashkengjitur dokumentat përkatës (numrat dhe datat e të cilëve shënohen në kutinë 44 të DAV). Kjo shumë zbritet nga shuma e RML sipas pikës 1 më lart, dhe shënohet në rubrikën RMZ (renta minerare e zbritur) të kutisë 47. Automatikisht sistemi informatik bën llogaritjet dhe në rubrikën RMN nxjerr diferencën e cila është edhe shuma që do të paguhet dhe që shfaqet në totalin e taksave në rrjeshtin e fundit të kutisë 47 të DAV.
3. Në rastet kur eksportuesi është shfrytëzues i mineralit, pra nuk ka blerë minerale apo me rentë të paguar prane organeve tatimore, atëherë në rubrikën RMZ shënohet shifra 0. Në këtë rast shuma në rubrikën RML është e barabartë me atë të rubrikës RMN, dhe është shuma totale për t'u paguar.

Elisa SPIROPALI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

N^o 488/3

UDHËZIM

dt 12.3.14

NR. 2/1, DATË 12. 3. 2014

**«PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 04.09.2008 «PËR
TAKSAT KOMBËTARE», I NDRYSHUAR»**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, në pikën II të pikës 2.4.1, paragrafi i tretë dhe i katërt zëvendësohen nga paragrafët me këtë përmbajtje:

Në momentin kur subjekti eksportues eksporton mineralin që ka blerë nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit apo nënproduktin mineral, ai paguan rentën minerare vetëm për diferencën ndërmjet vlerës së rentës së përlogaritur në bazë të çmimeve të eksportit që është çmimi FOB në Shqipëri, dhe vlerës së rentës të paguar nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit në përputhje me pikën 3 të vendimit nr. 7, datë 4.1.2012 "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare".

Në momentin e eksportit në degën doganore, në bazë të deklaratës së eksportit dhe dokumentacionit shoqërues, përlogaritet vlera e plotë dhe shuma e rentës minerare për sasinë e mineralit apo nënproduktit që po eksportohet.

Subjekti deklarues është i detyruar që në momentin e eksportimit, pranë organit doganor të vetëdeklarojë shumën e rentës minerare të paguar (pranë organeve tatimore) për sasinë e mineralit apo nënproduktit që po eksportohet, si dhe të depozitojë dokumentet përkatëse.

Shuma që do të paguhet në doganë, do të jetë diferenca ndërmjet shumës së llogaritur për vlerën e plotë të rentës dhe shumës së rentës të vetëdeklaruar si të paguar pranë organeve tatimore.

Organet tatimore, në bazë të të dhënave që marrin nga organet doganore, verifikojnë saktësinë e vetëdeklarimeve të bëra nga subjektet eksportuese dhe marrin masa për rregullimin e situatës në rast konstatimi të diferencave, si dhe njoftojnë organet doganore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shkëlqim CANI

